

KONTRATË SHITJE AKSIONESH

Sot më datë 21.01.2025, në Tiranë, palët e mëposhtme vendosën të lidhin kontratën e shitjes së aksioneve si më poshtë:

SHITËSI: Z. Asllan TROKSI, lindur më 25.02.1958, në Surrrel, shtetas Shqiptar, me adresë Rruga Nacionale Tiranë - Dajt, Njësia Administrative Dajt, Fshati Surrrel, Banese Private nr. 07, Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me nr. Personal F80225116V, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar (në cilësinë e **Shitësit**).

DHE

BLERËSI: Shoqëria "ALAR Consulting" shpk, person juridik i të drejtës shqiptare, me NIPT L71312045T, me seli në adresën Rruga "Donika Kastrioti", Pallati nr 8, kati 3, Apartamenti nr 2/3, Tiranë, përfaqësuar nga administrator, z. Astrit Hana, i datëlindjes 12.02.1940, mbajtës i letërnjoftim ID me numër personal E20212101R. (në cilësinë e **Blerësit**).

OBJEKTI: Shitja e **112,091** (Njëqind e dymbëdhjetë mijë e nëntëdhjetë një) **aksioneve** të "BANKA CREDINS" sh.a, që zotërohen nga aksioneri **Z. Asllan Troksi** dhe blerja e tyre nga **Shoqëria "ALAR Consulting" shpk**.

PËRMBAJTJA E KONTRATËS

Shoqëria "BANKA CREDINS" sh.a., është një shoqëri anonime e krijuar e që vepron si person juridik në bazë të ligjeve shqiptare, me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 28969, datë 31.01.2003, e regjistruar në Organet Tatimore me Kodin Fiskal Nr. 3709529, NIPT K31608801O, si dhe me licencën nr. 16, datë 31.03.2003 të lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

ÇMIMI I SHITJES SË AKSIONEVE DHE MËNYRA E PAGESËS

Palët kanë rënë dakord që 112,091 (Njëqind e dymbëdhjetë mijë e nëntëdhjetë një) aksione të shiten me një çmim 1.419 Euro/aksion, me çmimin total prej 159,057.13 (Njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e pesëdhjetë e shtatë pikë trembëdhjetë) Euro.

Pagesa në shumën e mësipërme do të kryhet në rrugë bankare dhe do të derdhet në llogarinë e Shitësit pranë Bankës Credins me nënshkrimin e kontratës.



MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË AKSIONEVE

Shitësi është plotësisht dakord dhe i shet me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë **Blerësit** 112,091 (Njëqind e dymbëdhjetë mijë e nëntëdhjetë një) aksione të shoqërisë “BANKA CREDINS” sh.a, që ai zotëron në kapitalin aksionar të Bankës.

Kalimi i pronësisë do të bëhet me pagesën e plotë të shumës 159,057.13 (Njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e pesëdhjetë e shtatë pikë trembëdhjetë) Euro nga ana e Blerësit Shoqëria “**ALAR Consulting**” shpk, në llogarinë e Shitësit **Z. Asllan Troksi**.

KLAUZOLAT PËR TË DREJTAT MBI DIVIDENTIN DHE TË TJERA

Aksionet objekt kontrate kalojnë dhe transferohen tek Blerësi së bashku me të gjitha të drejtat që shoqërojnë dhe lidhen me aksionet, përfshirë çdo lloj dividendi, rritje kapitali, e drejta e votës, dhe në përgjithësi çdo lloj e drejte tjetër e papërmendur, por që njihet nga statuti dhe ligji. Përfitimi i këtyre të drejtave bëhet së bashku me transferimin e pronësisë mbi aksionet nga Shitësi tek Blerësi me pagesën e çmimit të shitjes së aksioneve.

LIGJI I ZBATUESHËM


Palët bien dakord që kjo Kontratë do të zbatohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Për çfarë nuk parashikohet në këtë Kontratë aplikohen dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë mbi shitjen.

KLAUZOLA TË TJERA

Nese për shkaqe ligjore te ndryshme nga vullneti i paleve kjo kontrate dhe transferimi i aksioneve (objekt kontrate) nuk do të sjellin pasojat e dëshiruara, atehere palet do të gjejne zgjidhje me mirekuptim, duke u angazhuar per kete shkak.

Kontrata hartohet në 4 kopje origjinale, duke patur të gjitha vlerë të njëjtë, nënshkruhet prej palëve me dëshirë dhe vullnetin e tyre të plotë e të pavesuar.

SHITËSI
Asllan TROKSI



Asllan Troksi

BLERËSI

Shoqëria “**ALAR Consulting**” SH.P.K
Përfaqësuar nga Administratori

Astrit HANA



SHOQËRIA TREGTARE "ALAR Consulting" SHPK

Datë 20/01/2025

VENDIMI I ORTAKËVE TË SHOQËRISË "ALAR Consulting" SHPK

Sot, më datë 20/01/2025, në Selinë e shoqërisë, në Rruga "Donika Kastrioti", Pallati nr 8, Kati 3, Apartamenti nr 2/3, Tiranë, u mbledh asambleja e ortakëve të shoqërisë "ALAR Consulting" Shpk, e regjistruar në Regjistrin Tregtar më datë 12.01.2017, me NUIS L71312045T, e cila mori në shqyrtim rendin e ditës të bërë të njohur paraprakisht si më poshtë:

1. Blerjen nga shoqëria "ALAR Consulting" Shpk të një totali 112,091 (Njëqind e dymbëdhjetë mijë e nëntëdhjetë një) aksionesh të zakonshme, të cilat zotërohen nga Z. Asllan TROKSI në Bankën Credins Sh.a, për një çmim total prej 159,057.13 (Njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e pesëdhjetë e shtatë pikë trembëdhjetë) EURO.
2. Të autorizojë administratorin e shoqërisë "ALAR Consulting" Shpk, Z. Astrit Hana të përfaqësojë shoqërinë "ALAR Consulting" Shpk për nënshkrimin e kontratës së shitblerjes së aksioneve me Z. Asllan TROKSI, si dhe të ndjekë të gjitha procedurat dhe të nënshkruajë të gjitha dokumentat e nevojshme.

Në përfundim të mbledhjes, Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë "ALAR Consulting" Shpk:

VENDOSI:

1. Të miratojë blerjen nga Shoqëria "ALAR Consulting" Shpk të një totali 112,091 (Njëqind e dymbëdhjetë mijë e nëntëdhjetë një) aksionesh të zakonshme, të cilat zotërohen nga Z. Asllan TROKSI në Bankën Credins Sh.a, për një çmim total prej 159,057.13 (Njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e pesëdhjetë e shtatë pikë trembëdhjetë) EURO.
2. Të autorizojë administratorin e shoqërisë "ALAR Consulting" Shpk, Z. Astrit Hana të përfaqësojë shoqërinë "ALAR Consulting" Shpk për nënshkrimin e kontratës së shitblerjes së aksioneve me Z. Asllan TROKSI, si dhe të ndjekë të gjitha procedurat dhe të nënshkruajë të gjitha dokumentat e nevojshme.

ASAMBLEJA E ORTAKËVE TË SHOQËRISË "ALAR Consulting" SHPK

ORTAKËT

Astrit HANA

Astrit Hana



CF0429TR DEDAGROUP S.p.A. - Banking Division CF P 033 ALB EQ
22.01.2025 CREDINS BANK SH.A. - DEGA CREDINS TIRANA 15 - QPRINT
12:23:28 CR201/ALL

FunkSION: M (M) Sh.mby.

Llogaria: 1 00001878934 17 EUR TROKSI ASLLAN (S/N)

C/C - D/R : OPERAZIONI SU CONTO -----

Kod vepr: 11 PAGESE PER TE TRETE

Shuma : E 159.057,13 A Date veprim. 21.01.2025 / 15:32:07

Terminali / perdor.: ZN CF2047TR Date valuta 21.01.2025

Filiali regjistruar: 57 Date dispon. 21.01.2025

Derd. valuta mesat : Printuar ne NX/LL : N

Partita te prenot. : Lev. likuiduar : N

Nr. ceku : Lev.nenshtr. komis : N

Printuar MandKontab: N Printuar ne libeze : N

NrLev LL/R 0188115291 Forc.DtValut Forc. ceku N

Forc.zbuluar Forc. filiali S

N.Konv:

ORD.ALAR CONSULTING SH.P.K TRN No. E01-25000145612

KALIM SIPAS KONTRATES SHITJE AKSION ESH

----- CM41@10

F3=Fund punes F5=Info ZG11 F11=Dett. mov F12=Kthim





Date 20. 01.2025

LETTER OF APPROVAL

By which, I Clive Moody, in the quality of the representative of the holders of "A" general shares in the capital of "BANKA CREDINS" SH.A. (hereinafter referred to as the "Company"), B.F.S.E Holding BV, for the purposes of :

- (A) Article 9.5 of the Charter of the Bank and Law nr. 9901, dated 14.04.2008 "On entrepreneurs and companies", as amended and
- (B) Article 6.16 of the Investment Agreement entered into between the Company and its shareholders dated 14 December 2007 (the "Investment Agreement"),

Hereby give my approval for the transfer by sale of 112,091 shares held by Mr. Asllan Troksi in the capital of "CREDINS BANK" SH.A., to the Company "ALAR Consulting" sh.p.k.

After this transfer, Mr. Asllan Troksi loses the ownership on these shares, while the Company "ALAR Consulting" sh.p.k. becomes shareholder of "CREDINS BANK" SH.A.

This approval is conditional upon the following:

- (A) The consent of at least 2 of the Managers (as defined in the Investment Agreement); and
- (B) Compliance of Mr. Asllan Troksi with the Deed of Adherence for the terms of the Investment Agreement.

Clive MOODY

On behalf of BFSE Holding BV

C. Moody



Datë 20/01/2025

Letër Miratimi

Nëpërmjet kësaj letre miratimi, unë, Clive Moody, në cilësinë e përfaqësuesit të aksionerit BFSE Holding BV, mbajtës i aksioneve të zakonshme të tipit A në kapitalin e Banka Credins sh.a (në këtë dokument referuar "shoqëria"), për qëllim të:

- A. Neni 9.5 i Statutit të Bankës dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar dhe
- B. Neni 6.16 i Marrëveshjes së Investimit të lidhur mes shoqërisë dhe aksionerëve të saj më datë 14 Dhjetor 2007 ("Marrëveshja e Investimit"),

Jap miratimin tim për transferimin nëpërmjet shitjes së 112,091 aksioneve që Z. Asllan TROKSI zotëron në kapitalin e Banka Credins sh.a, tek Shoqëria "ALAR Consulting" sh.p.k.

Pas këtij transferimi, Z. Asllan TROKSI humbet pronësinë e këtyre aksioneve, ndërkohë që Shoqëria "ALAR Consulting" sh.p.k bëhet zotëruese e këtyre aksioneve.

Ky miratim është i kushtëzuar nga:

- A. Marrja e miratimit nga të paktën 2 Menaxherë (siç përcaktohet tek Marrëveshja e Investimit); dhe
- B. Pranimi nga ana e Shoqërisë "ALAR Consulting" sh.pk i Aktit të Mirëbesimit lidhur me termat dhe kushtet e Marrëveshjes së Investimit.

Clive Moody

Për llogari të BFSE Holding BV

(firma)

Për kthyer nga: Ronjola Srogo
Bary

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER JULIAN ZHELEGU**



**DATE 18/03/2025
NR REP 2292**

VËRTETIM PËRKTHIMI

Vertetoj nënshkrimin e përkthyesit Znj. Manjola Çraga, e bija e Mersin, lindur më 14/04/1979, në Tiranë dhe banuese në TIRANË, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Leternjoftim ID me nr. 037729458 dhe Nr. Personal H95414138E, e cila deklaroi se perktheu njësoj me origjinalin dokumentin bashkalidhur nga gjuha angleze ne gjuhen shqipe.

Unë, zevendesnoteri, duke gjetur këtë akt në përputhje me ligjin, e vërtetoj atë, në bazë të nenit 135 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

**NOTER
JULIAN ZHELEGU**

perfaqesuar me autorizim nga Zevendesnoteri

Elsa Gurra



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER JULIAN ZHELEGU**



**DATE 18/03/2025
NR REP 2291**

VËRTETIM NJËSIE ME ORIGINALIN

Sot, më datë 18/03/2025, në zyrën noteriale të Noter Julian Zhelegu, Noter i Dhomës së Noterëve Tiranë, në adresën Rr. Pjeter Bogdani, nr. 13, K. I, Tiranë, përpara meje Zëvendësnoteres Elsa Gurra, e autorizuar rregullisht nga Noteri për redaktimin e akteve dhe veprimeve noteriale gjatë mungesës së tij, u paraqit :

KËRKUESE:

Erisa Hysaj, atësia Asim, amësia Ema, shtetase Shqiptare, lindur në Pac, Tropojë dhe banues në Tropojë, me adresë Pac Tropoje; Bytyç; 0000; Tropojë, lindur më 18/05/2000, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 033520880 dhe nr. personal K05518034R;

E cila me kerkoi te vertetoj dokumentin bashkelidhur Leter Miratimi date 20.01.2024, ne gjuhen angleze perkthyer ne gjuhen shqipe.

Unë Zevendesnoteri, pasi i bëra të qartë personit të mësipërm, përgjegjësinë penale në rast paraqitje të dokumenti të rremë; bëra krahasimin e përmbajtjes së dokumentit origjinal me fotokopjen e paraqitur, mbi të cilat më rezultoi se nuk janë bërë korrigjime, shtesa, fshirje, a shenja të tjera të dyshimta.

Si rrjedhim, në bazë të nenit 62, shkronja "I", nenit 129 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë"; Vërtetoj se fotokopja e dokumentit të paraqitur nga kërkuesi para meje Zevendesnoterit, është e njëjtë me dokumentin origjinal.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Zevendesnoteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të kërkuesit të këtij dokumenti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

JULIAN ZHELEGU

Perfaqesuar me autorizim nga Zevendesnoteri Elsa Gurra





Julian ZHELEGU
STUDIO NOTERIALE
Rr. "Pjeter Bogdani", nr. 13
Tiranë, Shqipëri
NIPT: K61717003K

Tel & Fax: + 355 4 22 555 28 Mobil: + 355 68 20 27 818 E-mail: noteri@studiozhelegu.net

Nr. 3 Prot.

Tiranë, më 17.3.2025

AUTORIZIM

Bazuar ne nenin 66/3 te Ligjit 110/2018 "Për Noterinë" dhe duke qene se nuk do të ndodhem në zyrë prej datës 18.3.2025 (tetëmbëdhjetë mars dy mijë e njëzet e pesë) deri më datë 28.3.2025 (njëzet e tetë mars dy mijë e njëzet e pesë), autorizoj Zëvendësnoteren znj. Elsa GURRA, për te kryer shërbimet noteriale kundrejt palëve të treta, duke nënshkruar aktet noteriale dhe veprimet e tjera noteriale. Zëvendësnoterja autorizohet të redaktojë dhe nënshkruajë sipas ligjit aktet dhe veprimet noteriale, pa kufizim të kompetencave.

Zëvendësnoterja Elsa GURRA do të ushtrojë veprimtarinë prej orës 00:00 të datës 18.3.2025 (tetëmbëdhjetë mars dy mijë e njëzet e pesë) deri në orën 24:00 të datës 28.3.2025 (njëzet e tetë mars dy mijë e njëzet e pesë).

NOTERI

Julian ZHELEGU



Datë: 20.01./2025

Vendimi i Aksionerëve

Sot më datë 20.01./2025, aksionerët e BFSE Holding BV, një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit Hollandez, në qendër në Amsterdam, Hollandë, dhe zyra qendrore në adresën: Strawinskylaan 569, 1077 XX, Tower Ten 5th floor, World Trade Center, Amsterdam, Holande, vendosën sa më poshtë:

1. Të autorizojnë Clive David Moody, në cilësinë e Drejtorit të BFSE Holding BV, për të nënshkruar për llogari të kompanisë BFSE Holding BV, letrën e miratimit për transferimin nëpërmjet shitjes të:
 - 112,091 aksioneve që aksionari Z. Asllan TROKSI zotëron në kapitalin e "Banka Credins" sh.a., tek shoqëria "ALAR Consulting" shpk.

Aksionerët e Kompanisë:

Alar Consulting shpk Pa të drejtë frime për shkak të konfliktit të interesit

Përfaqësuar nga:

Astrit Hana

Shaga shpk

Përfaqësuar nga:

Shemsi Zemani

Shemsi Zemani

Edmond JAUPI

Firma

Dritan PASHAKO

Firma



Akt Mirëbesimi

Ky Akt Mirëbesimi është hartuar në datë 20..... të muajit Janar... 2025.

Nga: **Shoqëria "ALAR Consulting" shpk**, person juridik i të drejtës shqiptare, me NIPT L71312045T, me seli në adresën Rruga "Donika Kastrioti", Pallati nr 8, kati 3, Apartamenti nr 2/3, Tiranë, përfaqësuar nga administrator, z. Astrit Hana, i datëlindjes 12.02.1940, mbajtës i letërnjoftim ID me numër personal E20212101R. ("Pritësi").

- A. Sipas kushteve të marrëveshjes datë 14.12.2007 ("**Marrëveshje Investimi**") lidhur mes (1) Credins Bank SH.A ("**Kompanisë**"), (2) Menaxherëve (përcaktuar në këtë dokument), (3) Investuesit (përcaktuar në këtë dokument), (4) Aksionerët (përcaktuar në këtë dokument), (5) Z. Renis Tërshana dhe (6) BFSE Holding BV (përcaktuar në atë dokument), aksionari Z. Asllan TROKSI, ("**Transferuesi**") do t'i shesë dhe do t'i transferojë 112,091 aksione ("**Transferimi**") Pritësit që ka nënshkruar këtë Akt Mirëbesimi.
- B. Pritësi ka pranuar këto aksione me kushtet e përcaktuara dhe ka rënë dakord të nënshkruajë këtë Akt Mirëbesimi në përputhje me klauzolën 6.24 të Marrëveshjes së Investimit.

Ky Akt dëshmon si më poshtë:

- 1. Përcaktimet në këtë Marrëveshje Investimi duhet (veç rasteve kur përcaktohet ndryshe nga konteksti) të kenë të njëjtin kuptim kur përdoren në këtë Akt Mirëbesimi.
- 2. Pritësi ndërmerr veprime dhe angazhohet me të gjitha palët e Marrëveshjes së Investimit (përfshirë çdo person që ka nënshkruar këtë Akt Mirëbesimi në përputhje me Marrëveshjen Investimit) për të qenë në përputhje, në fuqi nga data e Transferimit, me dispozitat dhe për të përmbushur të gjitha detyrimet e përcaktuara në Marrëveshjen e Investimit në mënyrë që ato të zbatohen dhe të përmbushen njësoj sikur Pritësi të kishte qenë palë në Marrëveshjen e Investimit si një Aksioner.
- 3. Asgjë që përmban ky Akt Mirëbesimi, mes Transferuesit dhe Kompanisë, nuk do të përbëjë një arsye për të hequr dorë nga ndonjë detyrim i Transferuesit sipas Marrëveshjes së Investimit dhe as nuk do të ketë ndikim në asnjë mënyrë mbi të drejtat e Kompanisë që lindin nga ndonjë shkelje e Marrëveshjes së Investimit përpara datës së Transferimit (përfshirë gjithashtu prishjen e Garancive).
- 4. Për të shmangur dyshimet, Pritësi do të kryejë çdo pagesë të prapambetur ndaj Transferuesit nga data e Transferimit dhe do të jetë përgjegjës për çdo shkelje ose mos përmbushje e detyrimeve të Transferuesit në përputhje me Marrëveshjen e Investimit nga data e Transferimit deri në datën e këtij Akti (përfshirë).



5. Pritësi mendohet të ketë marrë përsiper përgjegjësinë në lidhje me kostot, pretendimet, dëmtimet ose detyrimet që dalin nga Marrëveshja e Investimit për arsye të një akti ose heqje nga data e Transferimit.
6. Pritësi, për të shmangur dyshimet, njihet si mos përfaqësues në lidhje me Garancitë.

Në praninë e dëshmitarit ky Akti Mirëbesimi është zbatuar si një akt dhe është dërguar në datën e përcaktuar në krye të faqes 1.

NENSHKRUAR si një Akt nga:

Shoqëria "ALAR Consulting" SH.P.K

Përfaqesuar nga Administratori:

Astrit HANA

Në praninë e:

Firma e dëshmitarit:

Emër: Dora VAKO

Adresë: Rruga Vaso Pasha nr.8 Tiranë

Profesioni: Sekretare e Korporatës

Pranuar dhe rënë dakord për llogari dhe në emër të Banka Credins SH.A, e cila vepron për llogari të vetën dhe të të gjitha palëve në Marrëveshjen e Investimit (përfshirë çdo person që ka nënshkruar këtë Akt Mirëbesimi në përputhje Marrëveshjen e Investimit).

Maltin KORKUTI

Për llogari dhe në emër të Banka Credins SH.A

Monika MILO

Për llogari dhe në emër të Banka Credins SH.A

